

HAPPEL: GREQIA? HARROJE!



Mbi përpjekjet për të organizuar një udhëtim studimi në Greqi. Kur veç u grumbulluan të gjitha dokumentet e nevojshme për aplikim për vizë, ata shkuan së bashku me formularët e plotësuar të tyre në zyrën ndërlidhëse greke në Prishtinë. Për pak javë duhej të merreshin vizat, kështu të paktën ishte përvoja me ambasadat tjera këtu. Por pak javë para se të niseshin për udhëtim, erdhi befasia

Prizren

Për çdo vit, pasi të kryhet testi kombëtar me shkrim, nisen maturantët së bashku me disa nga profesorët e tyre në udhëtimin e obliguar të tyre. Caqe të udhëtimit në vitet e kaluara ishin në mes tjerash edhe Turqia dhe Bullgaria. Në vitin 2012 planifikuan ata për në Greqi, në Nea Moudania, në afërsi të Selanikut, ku veç ishte siguruar akomodimi.

Tani duhej të bëhej aplikimi për vizë në zyrën ndërlidhëse greke në Prishtinë. Kur veç u grumbulluan të gjitha dokumentet e nevojshme për aplikim për vizë, ata shkuan së bashku me formularët e plotësuar të tyre në zyrën ndërlidhëse greke në Prishtinë. Për pak javë duhej të merreshin vizat, kështu të paktën ishte përvoja me ambasadat tjera këtu.

Por pak javë para se të niseshin për udhëtim, erdhi befasia. Tani kërkoheshin dokumente shtesë, si për shembull dëshmia e xhironlogarisë bankare dhe shuma e të hollave të deponuara, një dëshmi, që së paku njëri nga prindërit duhej të ishte i punësuar dhe nga ai duhej të sillej vërtetimi i pagës, për prindërit që jetonin në ndonjë vend të huaj vërtetimi e përkthyer dhe të vërtetuar, që ai jeton atje legalisht, një kopje të vërtetuar të certifikatës së kurorëzimit të prindërve dhe shumë kushte tjera errëta. E çuditshme ishte para së gjithash, që të gjitha këto duhej të bëheshin brenda tri ditësh. Pas një intervenimi me shkrim që e bëra unë si qytetar i Unionit Evropian, që kushtet e lëshimit të vizës Shengen duhej të mjaftonin, u heq dorë nga kërkesa për sjelljen e dokumenteve shtesë.

Por heqja dorë erdhi atëherë kur i skadoi afati udhëtimit të rezervuar për në Nea Moudania. Nga kjo u kuptua: Greqia? Harroje! Kjo nuk duhej t'i ndodhte maturantëve prapë në vitin 2013. Me kohë u grumbulluan të gjitha dokumentet e kërkuara, u plotësuan formularët, dhe u sollën ata së bashku me pasaportat dhe fotografitë biometrike të kërkuara, por prapë nuk u pranua. Duhej të zgjaste kohë deri sa të bëhej një termin, që të mund të informohesh, çka nuk ishte në rregull.

Tani u kërkuan prapë, sikur edhe vitin e kaluar dokumente shtesë. Prapë mora rrugën për në zyrën ndërlidhëse greke në Prishtinë si qytetar i Unionit Evropian, ku pas një pritjeje në hyrje, mora përgjigje nga ta, që dokumentet e kërkuara ishin të domosdoshme si procedurë edhe për ambasadat tjera dhe zyrat ndërlidhëse këtu. Por ky nuk është rast i njëjtë, duke ju falënderuar përvojës së aplikimit dhe marrjes së vizave në ambasadën gjermane dhe austriake, të cilat na janë nevojitur për nxënësit që kanë marr pjesë në shkëmbimin e nxënësve dhe për seminare në Gjermani dhe Austri. Përmes një thirrjeje në ambasadën e Gjermanisë u vërtetua shumë shpejtë, por e cila po ashtu nuk ndihmoi. Vërtetimi provokoi vetëm një buzëqeshje të lodhshme.

Për nxënësit duheshin këto dokumente shtesë, pasi që duhej të ishte e sigurt që ata nuk do të rrinë ilegalisht në Greqi. Ky ishte vetëm një argument i pabazë! Kush nga ata, të cilët ishin disa herë në Gjermani ose Austri dhe u kthyen e nuk qëndruan ilegalisht atje, do të rrinte vullnetarisht dhe atë ilegalisht në Greqi? Kjo nënkupton në vete prapë: Greqia? Harroje! Por si do të ishte, nëse do ta bënim një udhëtim seminarik për arsimtarët në Greqi, në javën e dytë të qershorit 2013? Të gjithë janë të punësuar, pra ekonomikisht të siguruar. Të gjithë mund të sjellin kontrata dhe dëshmi të pagës, shumë prej tyre janë të martuar dhe kanë fëmijë.

Pra, na mbetet vetëm të planifikojmë dhe të aplikojmë me kohë për vizë. Tanimë mungonte vetëm termini për dorëzimin e dokumenteve në zyrën ndërlidhëse greke në Prishtinë. Kjo me siguri do të ishte bjeshkë për t'u kaluar. Në mes të prillit u informuam që ishte herët ende për të bërë një termin për dorëzimin e kërkesave, ndërsa në fillim të majit ishte më shumë se vonë. Në fillim të majit nuk mund të bëhej termini, për shkak të javës të javës së madhe dhe para tyre të pashkëve ortodokse me 5 maj. Thirrjeve pas festave, për caktimin e një termini, iu dha përgjigje prapë me neglizhencë, që së shpejti do të thërrisnin prapë. Më në fund, më 15 maj thirrën.

Shkurt e trup u tha, që tani për tani kishte shumë punë në zyrën ndërlidhëse greke, dhe se edhe përkundër dëshirës së tyre kërkesat për pesëdhjetë viza nuk mund të punoheshin deri më 6 qershor. Për të tretën herë: Greqia? Harroje! Tani mirë, jemi të detyruar të kuptojmë, që ne si mysafirë nuk jemi të mirëseardhur në Greqi. Vërtetë kultura evropiane, siç thuhet, është themeluar në kodrat e Golgotës, Akropolisit dhe në shtat kodrat e Romës, por për kërkimin e gjurmëve në Greqi duhet të hiqet dorë dhe kjo bëhet më mirë në Turqi. Atje janë gjurmët e para të Greqisë së madhe, në numër të madh dhe prezente dhe mysafirët janë të mirëseardhur.

Atje janë njerëzit më miqësor dhe nuk ka taksa për viza, pasi që nuk kërkohen vizat. Politika me siguri vazhdon të flas, sa e rëndësishme është që të lidhet Kosova me Evropën, dhe edhe më tutje po jepen të holla për zhvillimin e vendit, si dëshmi e seriozitetit. Por edhe më tutje duhet të bëhen aplikime për viza, që si kosovarë të mund të udhëtosh në Evropë. Edhe më tutje, për udhëtimet për në Gjermani, Austri, Zvicër e kështu me radhë, jo vetëm që është e mundur të aplikosh për viza, por vizat janë edhe shumë të mirëseardhura nga ta. Por për Greqinë vlen edhe më tutje dhe e pandryshuar: Greqia? Harroje! Dhe këtë do ta bëjmë nga tani e tutje sigurisht.

(Autori është drejtor në shkollën gjermane "Loyola-Gymnasium", Prizren)